

RAPORT

Janar – Mars 2025



FUSHË KOSOVË,
Prill 2025

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK-TRAINKOS SH. A.	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR	6
III.1	Gjendja financiare janar – mars 2025	6
III.1.1	Të hyrat	6
III.1.2	Shpenzimet	7
III.2	Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 31.03.2025	10
III.3	Transaksionet e realizuara (janar – mars 2025)	11
III.4	Bilanci i gjendjes (31.03.2025).....	12
IV.	TRANSPORTI I UDHËTARËVE	13
IV.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU	13
IV.2	Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)	14
IV.3	Vonesat e trenave të udhëtarëve	14
V.	TRANSPORTI I MALLRAVE	15
V.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM	15
V.2	Shfrytëzimi i trenave	17
V.3	Efektiviteti i trenave	17
V.4	Neto-ton & neto-ton-kilometër të transportuar	17
V.5	Revokimi i trenave	18
V.6	Organizimi i tërheqjes me lokomotiva dhe lokomotiva manovruese – shpenzimet e naftës.....	18
VI.	MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE – MML	19
VI.1	Pasqyra e performancës operative	19
VI.2	Sektori i Mirëmbajtjes.....	19
VI.3	Mirëmbajtja e trenave motorikë.....	19
VI.4	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese.....	19
VI.5	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese.....	20
VI.6	Intervenimet në mjetet tërheqëse.....	20
VI.7	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve.....	20
VI.8	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave.....	21
VI.9	Riparimi i vagonëve të huaj.....	21
VII.	PROJEKTET DHE PROKURIMI.....	22
VII.1	Projektet kapitale	22
VIII.	KONTESTET LIGJORE.....	24
VIII.1	Kontestet ligjore për vitin 2025	24
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT	25
IX.1	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit.....	25
IX.2	Aktivitetet në transportin e mallrave.....	25
IX.3	Aktivitetet në fushën promovuese.....	25
IX.4	Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera.....	26
IX.5	Pjesëmarrja e HK-Trainkos Sh.A. në iniciativat e BE-së.....	27
IX.6	Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante.....	27
X.	Sfidat kryesore gjatë periudhës janar – mars 2025 dhe veprimet për të ardhmen.....	28

I. HYRJE

Raporti për periudhën janar – mars 2025, për HK-Trainkos Sh.A. është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të Ndërmarrjes duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet aktivitetet gjatë këtij tre mujori (janar –mars 2025) në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu, në këtë raport pasqyrohen vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të Ndërmarrjes për këtë tremujor, sfida këto që përcillen nga periudhat paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në (mos) arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë nga mungesa e kërkesës në treg, veçanërisht atyre të transportit të mallrave nga shkaku i mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore. Mbyllja e kësaj linje ka pamundësuar zhvillimin e transportit ndërkombëtar dhe transportin e brendshëm të mallrave. Newco Ferronikeli, si klienti ynë kryesor, edhe pse ishte zotuar për transport të brendshëm të mallrave, kjo nuk është realizuar.

Transporti i udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Pejë dhe anasjelltas vazhdon të bëhet me shumë vështirësi, kjo për shkak të vjetërsisë dhe gjendjes jo të mirë të mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra.

Sa i përket transportit të udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Shkup - Prishtinë (Maqedoni e Veriut) treni ende nuk është lëshuar në qarkullim për shkak punimeve që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, Fushë Kosovë – Hani i Elezit. Kjo ndërprerje e qarkullimit do të vazhdojë deri në rehabilitimin e plotë të këtij segmenti hekurudhor.

Pavarësisht vështirësive të paraqitura, HK-Trainkos Sh.A. ka vazhduar përpjekjet për të menaxhuar situatën dhe për të siguruar funksionimin e proceseve të brendshme në përputhje me mundësitë e kufizuara. Megjithatë, ndikimi i faktorëve të jashtëm, përfshirë ndërprerjet e linjave hekurudhore dhe mungesa e kërkesës për transport mallrash, ka bërë të pamundur realizimin e objektivave të Planit të Biznesit për këtë periudhë

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH.A.

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK - Trainkos - SH.A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK - Trainkos - SH.A. më 01 Janar 2025 dhe më 31 Mars 2025				
Totali i të punësuarve	01.01.2025		31.03.2025	
	173		159	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2025	31.03.2025	01.01.2025	31.03.2025
Mosha mesatare e punëtorëve	48.13 %	48.31 %	%	%
Në marrëdhënie të rregullt pune	173	159	%	%
Meshkuj	149	135	86.12 %	84.90 %
Femra	24	24	13.87 %	15.09 %
Serbë	1	1	0.57 %	0.62 %
Shqiptarë	172	158	99.42 %	99.37 %
Me shkollim fillor	3	3	1.73 %	1.88 %
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	95	81	54.91 %	50.94 %
Me kualifikim profesional	20	20	11.56 %	12.57 %
Me përgatitje të lartë	2	2	1.15 %	1.25 %
Me përgatitje superiore	53	53	30.63 %	33.33 %
Zyrtarët e Lartë	3	3	1.74 %	1.88 %
Departamenti për Operime Hekurudhore	104	92	60.11 %	57.86 %
Departamenti i Administratës	36	35	20.80 %	22 %
Departamenti i Financave	4	4	2.31 %	2.51 %
Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim të Biznesit	11	11	6.35 %	6.91 %
Kabineti i KE-së	2	2	1.15 %	1.25 %
Zyra e Prokurimit	3	2	1.74 %	1.25 %
Njësia e Auditimit të Brendshëm	1	1	0.57 %	0.62 %
Sektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	9	9	5.20 %	5.66 %

Vërejtje: Në tabelën e cekur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë tremujorit Janar - Mars 2025, në Ndërmarrje ka pasur lëvizje/ndryshime të stafit në numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

Lëvizjet e të punësuarve – TM1-2025

Nr.	Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	
1	Aktiv në fillim muaj	173	162	159	173
2	Të pensionuar	1	0	0	1
3	Të larguar	10	2	0	12
4	Të vdekur	0	0	0	0
5	Të dorëhequr	0	1	0	1
6	Të punësuar	0	0	0	0
7	Frekuenca në fundmuaj	173	162	159	159

Në bazë të dhënave në tabelën me lart, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve më datën 01.01.2025 kanë qenë 173, ndërsa me datën 31.03.2025 kanë qenë 159 punëtorë. Shpjegim i tabelës lëvizjet e të punësuarve – TM1 – 2025.

Një punonjës është pensionuar, dhjetë punonjës janë larguar pas vendimit të Komisionit Disiplinor, dy punëtor ju ka shkëput marrëdhënia punës për mos nënshkrim të kontratës dhe një punonjës ka dhënë dorëheqjen.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare Janar – Mars 2025
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.03.2025)
3. Transaksionet e realizuara (janar - mars 2025)
4. Bilanci i Gjendjes (31.03.2025)

III. 1 Gjendja financiare Janar - Mars 2025

Për periudhën raportuese Janar – Mars 2025, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III. 1.1. Të hyrat

Gjatë periudhës Janar – Mars 2025 nga **transporti i mallrave** nuk kemi realizuar të hyra. Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i mallrave për këtë periudhë raportuese ka qenë 250,000.00€, e cila nuk është realizuar për arsye që linja e 10-të ende qëndron e mbyllur, gjithashtu edhe klienti ynë kryesor Newco Ferronikel nuk është duke realizuar të hyra nga transporti i brendshëm.

Transporti i udhëtarëve për periudhën Janar – Mars 2025 është realizuar në shumën totale prej 404,614.36€. Prej këtyre të hyrave, nga transporti i kontraktuar me MMPHI për OSHP janë realizuar 239,906.56€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve nga ME janë realizuar 150,000.00€, ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 14,707.80€.

Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i udhëtarëve për këtë periudhë raportuese ka qenë 495,068.75€, realizimi i të cilave është arritur në shkallën prej 81.72%.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës Janar – Mars 2025 janë realizuar në shumën prej 2,127.97€. Kjo e hyrë është realizuar nga kontrata me kompaninë GCF në vlerë prej 1,500.00€ dhe shitja e bureve të zbraza në vlerë prej 627.97€, ndërsa në pozicionin e të hyrave nga RIV-i dhe vendosje e vagonëve në binarë nuk kemi realizuar të hyra për këtë periudhë.

Të hyrat totale nga kjo kategori kanë qenë të planifikuara në shumën prej 7,500.00€, ndërsa realizimi i tyre është arritur në shkallën prej 28.37%.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës Janar – Mars 2025, kanë arritur shumën prej 12,470.01€. Këto të hyra janë realizuar në pozicionet si: të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A., në shumën prej 4,228.64€, të hyrat nga qiraja në shumën prej 7,627.12€, si dhe të ardhura nga interesi nga llogaria FLEX në vlerë prej 614.25€, ndërsa nga pozicioni i të hyrave nga shitjet tjera (riparimi i vagonëve) nuk kemi realizuar të hyra në këtë periudhë. Të hyrat nga kjo kategori, krahasuar me planifikimin prej 26,500.00€, janë realizuar në shkallën prej 47.06%.

III. 1.2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën Janar – Mars 2025, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën raportuese është në shumën prej 53,867.01€. Planifikimi i këtyre shpenzimeve për TM1 ka qenë në shumën prej 193,500.00€ dhe arrin kuotën e realizimit në shkallën prej 27.84%.

Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2025.

Shpenzimet e stafit janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur realizimin në shumën prej 312,392.11€. Këto shpenzime kanë qenë për kategorinë paga dhe kontribute në vlerë prej 311,952.11€ dhe 440.00€ kanë qenë për trajnime apo shpenzime tjera. Në total, nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar (362,500.00€) për TM1 të vitit 2025, në këtë kategori kemi arritur kuotën e realizimit në shkallën prej 86.18%.

Totali i shpenzimeve operative arrin shumën prej 11,406.43€, e cila është realizuar në shkallën prej vetëm 43.74% nga shuma e planifikuar prej 26,075.00€ për TM1 - 2025. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2025.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 17.32%, konkretisht në shumën prej 5,031.28€. Planifikimi për këto shpenzime për TM1-2025 ka qenë në shumën prej 29,050.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2025:


Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2025

	EMËRTIMI	Planifikimi Janar - Mars 2025	Realizimi Janar - Mars 2025	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar - Mars 2024
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	250,000.00	-	250,000.00	-	6,004.61
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	325,000.00	239,906.56	85,093.44	73.82	272,503.25
3	TU – Ministria e Ekonomisë	152,568.75	150,000.00	2,568.75	98.32	152,568.75
4	TU – Shitja e Biletave	17,500.00	14,707.80	2,792.20	84.04	13,059.58
5	Shërbimet tjera	7,500.00	2,127.97	5,372.03	28.37	1,500.00
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	5,000.00	-	5,000.00	-	-
7	Të hyrat tjera jo operative	21,500.00	12,470.01	9,029.99	58.00	12,705.64
I	TOTAL – TË HYRAT	779,068.75	419,212.34	359,856.41	53.81	458,341.83
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	193,500.00	53,867.01	139,632.99	27.84	93,658.56
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	5,375.00	11,026.85	(5,651.85)	205.15	4,828.43
3	Inventar dhe pajisje	1,250.00	-	1,250.00	-	-
4	Material harxhues	250.00		250.00	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	15,000.00	135.51	14,864.49	0.90	10,109.09
6	Qasja në binarë	80,000.00	42,240.78	37,759.22	52.80	44,209.69
7	Sigurimi i palëve të treta	1,250.00	-	1,250.00	-	-
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	2,500.00	-	2,500.00	-	-
9	KMSH Nafta Infrakos	5,000.00	4,280.82	719.18	85.62	7,611.93
10	Servisimi i arkave fiskale	1,250.00	-	1,250.00	-	1,830.50
12	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	305,375.00	111,550.97	193,824.03	36.53	162,248.20
	Fitimi (humbja) bruto	473,693.75	307,661.37	166,032.38	64.95	296,093.63
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	361,250.00	311,952.11	49,297.89	86.35	356,505.17
2	Kontrollet sistematike shëndetësore, trajnime dhe shpenzime tjera	1,250.00	440.00	810.00	35.20	571.00
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	362,500.00	312,392.11	50,107.89	86.18	357,076.17
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	1,250.00	-	1,250.00	-	571.00
2	Shpenzimet logjistike	2,500.00	417.41	2,082.59	16.70	13,757.61
3	Energjia elektrike dhe komunal	1,750.00	253.85	1,496.15	14.51	26.08
4	Kontrollimet sistematike	750.00	150.00	600.00	20.00	-
5	Marketingu	2,250.00	930.48	1,319.52	41.35	292.14

6	Udhëtimet zyrtare	750.00	-	750.00	-	251.52
7	Telefonat dhe Posta	2,375.00	2,068.60	306.40	87.10	2,212.87
8	Shërbimet bankare	250.00	156.94	93.06	62.78	189.35
9	Tatimet	10,500.00	7,157.45	3,342.55	68.17	50.59
10	Pajisje elektronike	3,700.00	271.70	3,428.30	7.34	423.47
	TOTAL - Shpenzimet operative	26,075.00	11,406.43	14,668.57	43.74	17,774.63
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	2,500.00	-	2,500.00	-	-
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	7,000.00	900.00	6,100.00	12.86	600.00
3	Material i zyrës	4,375.00	1,449.82	2,925.18	33.14	2,382.31
4	Material sanitar	1,750.00	20.69	1,729.31	1.18	415.35
5	Qiraja për objektet	3,750.00	1,940.11	1,809.89	51.74	1,707.13
6	Reprezentacioni dhe bufeja	1,000.00	101.30	898.70	10.13	582.56
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	1,175.00	31.00	1,144.00	2.64	18,078.72
8	Shpenzimet logjistike	5,000.00	252.38	4,747.62	5.05	715.06
9	Kontigjente	2,500.00	335.98	2,164.02	13.44	-
	TOTAL - shpenzimet administrative	29,050.00	5,031.28	24,018.72	17.32	24,481.13
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	-
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	723,000.00	440,380.79	282,619.21	60.91	561,580.13
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	56,068.75	(21,168.45)	77,237.20	(37.75)	(103,238.30)
	GRANTET	102,500.00	120,939.12	(18,439.12)	117.99	77,488.86
F	Shpenzimet e zhvlerësimit		-			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	72,500.00	120,939.12	(48,439.12)	166.81	77,488.86
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	30,000.00	13,076.61	16,923.39	43.59	13,430.67
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	102,500.00	134,015.73	(31,515.73)	130.75	90,919.53
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	26,068.75	(34,245.06)	(8,176.31)	(131.36)	(116,668.97)


Tabela Nr. 3.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Janar - Mars 2025



Diagrami Nr. 3.2

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Janar - Mars 2025



Diagrami Nr.3.3

III.2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 31.03.2025

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31.03.2025
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	6.05
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	0.86
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	2.89
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	0.50
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	27.52
7	PCB nr. 1114-004229-0001-65	189,178.94
	TOTALI	189,216.76

Tabela Nr. 3.4

III.3. Transaksionet e realizuara (Janar - Mars 2025)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse, llogarinë e projekteve kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	1,172.54
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar - mars 2025	371,898.67
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2025	373,065.07
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2025	6.14

Tabela Nr. 3.5

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	0.86
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar - mars 2025	0.00
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2025	0.00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.01.2025	0.86

Tabela Nr. 3.6

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MI dhe ME) në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	4.38
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar - mars 2025	50,893.75
Pagesat e kryera gjatë muajve janar - mars 2025	50,894.78
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.01.2025	3.35

Tabela Nr. 3.7

Transaksionet e kompanisë Llogaria e kursimeve FLEX në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2025	526,109.79
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar - mars 2025	11,380.00
Pagesat e kryera gjatë muajve janar - mars 2025	348,310.85
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.01.2025	189,178.94

Tabela Nr. 3.8

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Janar - Mars 2025 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Janar - Mars 2025			Pagesat Janar – Mars 2025		
1	Deponim nga Transporti i udhëtarëve	12,919.00	1	Pagat e punëtorëve	267,010.28
2	Deponim nga KMDK	8,313.57	2	Pagesa për ATK	45,423.23
3	Deponim nga GCF	1,000.00	3	Pagesa për Hib Petrol	35,427.13
4	Te hyra nga shitja e bureve	741.00	4	Pagesa për ARH	8,100.00
5	Te hyrat nga FLEX	614.25	5	Pagesa për Enternet Shpk	2,159.99
TOTALI		23,587.82	TOTALI		358,120.63

Tabela Nr. 3.8

III.4. Bilanci i Gjendjes (31.01.2025)

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	GJENDJA FILLESTARE 01.01.2025	GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2024
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	2,242,734.25	2,113,517.83
Mjetet Qarkulluese	1,012,659.08	1,105,403.45
Stoqet	420,534.77	482,093.69
Paraja	528,003.53	190,559.50
Llogarite e arketueshme	51,179.71	419,930.79
Kerkesa tjera te arketushme	3,026.72	2,905.12
Parapagimet	9,914.35	9,914.35
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	3,255,393.33	3,218,921.28
Detyrimet afatshkurta	2,117,841.31	2,236,553.45
Llogarite e pagueshme	754,837.32	879,118.96
Te pagueshme tjera - detyrime	558.44	1,453.32
Detyrime tatimore	997,482.55	991,018.17
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
Detyrimet afatgjata	1,554,696.31	1,433,757.19
Kapitali	5,294,036.25	5,294,036.28
Fitimi/Humbja e bartur	-5,222,550.72	-5,711,180.58
Fitim/ Humbja e vitit	-488,629.86	-34,245.06
Total detyrimet dhe kaptali	3,255,393.32	3,218,921.28

Tabela Nr. 3.9.

IV.TRANSPORTI I UDHËTARËVE

IV.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU

Gjatë periudhës Janar – Mars 2025/ numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar është 17,408 ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave dhe ID kartelat është 14.878.73€ (pa TVSH). Krahësuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2024, numri i udhëtarëve në TM1 2025 është për 606 udhëtarë më shumë, apo shprehur në përqindje 3.61 %,më shumë. Krahësuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për 4592 udhëtarë më pak, apo shprehur në përqindje, -20.37%. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për 755.760 € më shumë, apo +5.35 %, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për + 556.91 € më shumë, apo + 3.28 %.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për periudhën **janar - mars 2025** si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar,dhe planifikimin për periudhën raportuese në TM1 2025:

Sqarim : në numrin total të udhëtarëve nuk janë të përfshira kategoritë e liruar nga pagesa,këto kategori nuk paguajnë biletë ,mirëpo janë kategori të cilat frekuentojnë mjaft shumë transportin hekurudhorë.

Të dhënat për numrin e udhëtarëve për periudhën TM1 2025							
Përshkrimi	Realizim TM1 2024	Realizimi TM1 2025	Planifikim TM1 2025	Dallimi: Realizim TM1 2025 – TM1 2024	Dallimi: Realizim - planifiki m TM1 2025	Dallimi në %: TM1 2025 – TM1 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM1 2025
Janar – Mars	16 802	17 408	22 000	+ 606	- 4592	+ 3.61 %	- 20.37 %

Tabela Nr. 4.1

Të dhënat për realizimin financiar në transportin e udhëtarëve për periudhën TM1 2025							
Përshkrimi	Realizimi TM1 2024	Realizimi TM1 2025	Planifikimi TM1 2025	Dallimi: Realizim TM1 2025 – TM1 2024	Dallimi: Realizim - planifikim TM1 2025	Dallimi në %: TM1 2025 – TM1 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM1 2025
Janar –Mars	14,122.97	14,878.71	17000	+755.76	+556.91	+5.35%	+ 3.23%

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër të udhëtarëve më të madhë krahasuar me vitin e kaluar por më të vogël në krahasim me planifikimin.

IV.2 Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)

Numri i trenave të udhëtarëve për këtë periudhë tremujore gjithsej ka qenë **541** ndërsa numri i përgjithshëm i udhëtarëve për kilometër (udhëtar/kilometër) ka qenë **565,565.76** Sa i përket totalit të kilometrave të zhvilluara nga të gjithë trenat e transportit të udhëtarëve (tren/km) ka qenë **32,891.00. dhe V/kom 40.95 km/h**

IV.3 Vonesat e trenave të udhëtarëve

Prej 547 trenave kanë operuar në këtë periudhë raportuese kan shkaktuar vonesa, të cilat janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje (%)
Lokomotiva HM	0	0
Vazhdimi i udhëtimit	0	0
Kryqëzimet	0	0
Lokomotiva/GM defekt	0	0
Lidhja me trenin	0	0
Bashkëngjitja e vagonëve/tërheqja e mjeteve	0	0
Doganë + Polici	0	0
Pritje në garniturë	0	0
Aksidente	3	0
Në nisje	217	6.86
Në arritje	2944	93.14
Të tjera	0	0
Total vonesat	3161	100

Tabela Nr. 4.3

V. TRANSPORTI I MALLRAVE

V.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave për periudhën janar – mars 2025 si dhe do të behët krahasimi me planifikimin dhe me realizimin për periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Gjatë periudhës janar - mars 2025 nuk ka pasur fare transport . Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2024, në TM-1 janë transportuar 1,274.66,neto- ton mallra, ndersa shuma e të hyrave nga ky transport ka qenë 6,004.61€. Mirëpo, nëse krahasojmë realizimin me planifikimin për TM-1 2025,është 0.00% mallra të transportuara ,ndërsa ne TM-1.2024 janë -118,725.34 neto-tonë mallra më pak të transportuara, apo shprehur në përqindje, është realizuar vetëm 1.06% e planifikimit. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është 0.00€, apo shprehur në përqindje, të hyrat janë 0.00%, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për -244,000.00€, apo shprehur në përqindje 0.00% nuk është realizuar fare transporti sipas planifikimit.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për periudhën janar - mars 2025 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe me planifikimin për periudhën raportuese në TM1 2025.

Realizimi në transportin e mallrave:

Janar- Mars 2025	Realizimi Neto Ton 2024	Realizimi Neto Ton 2025	Planifikimi Neto Ton 2025	Dallimi Realizim 2025/2024	Dallimi Realizim- Planifikim 2025	Dallimi Realizim 2025/2024 (%)	Dallimi Realizim- Planifikim 2025(%)
Sasia e transportuar	1,274.66	0.00	105,000	0.00	-105,000	0.00%	0.00%

Tabela 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 5.1, transporti nuk është realizuar fare 0.00% të planifikimit.

Transporti i mallrave me kontejnerë për periudhën janar – mars 2025 ka qenë:

Numri i transportuar i kontejnerëve	Kontejnerë të plotë 2025	Kontejnerë të zbrazët 2025
Sasia	0.00	0.00

Tabela 5.2

Sasia e transportuar në neto-ton për periudhën janar - mars 2024 në formë diagrami:




Figura 5.1

Siç mund të shihet nga figura 5.1 në aspektin operativ nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën janar - mars 2025.Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Të hyrat Janar-Mars 2025	Realizim shitje të hyra 2024	Realizim shitje të hyra 2025	Planifikim 2025	Dallimi në Realizim 2025/2024	Realizim-Planifikim 2024	Realizim 2025/2024 (%)	Realizim-Planifikim 2025 (%)
Vlera €	6,004.61	0.00	244,000.00	0.00	-244,000.00	0.00%	0.00%

Tabela 5.3

Siç mund të shihet nga tabela më lart, të hyra nuk kemi pasur,nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën janar- mars 2025.

Të hyrat në periudhën Janar-Mars 2025 në formë diagrami:




Figura 5.

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Të hyrat dhe shpenzimet	Shitjet/të hyrat në TM	Të ardhura tjera nga TM	Total shitjet	Shpenzimet direkte në TM	Shpenzim et indirekte në TM	Total Shpenzime t	Fitimi/hu mbja operative	Fitimi/humbja në %
Vlera €	0.00	2,127.97	0.00	65,873.13	569.00	66,442.13	(64,314.16)	30.22%

Tabela 5.4

Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marrë 1.64% të shpenzimeve në total të kompanisë kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me trena (*tren kilometër*) në komunikacion.

V.2 Shfrytëzimi i trenave

Për shkak të punimeve në Linjën e 10-të Hekurudhore, në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit, linja ka qenë e mbyllur gjatë gjithë kohës, Ndërsa, transporti vendor nuk është realizuar sipas planifikimeve, për shkak të mos fillimit të transportit të xehes nga Ferronikeli.

Janar – Mars 2025	Trena të planifikuar	Trena të shfrytëzuar	Shfrytëzim/Planifikim në % 2025
Import	0	0	0.00 %
Export	0	0	0.00 %
Vendor	228	0	0.00 %
Total	228	0	0.00 %

Tabela 5.5

V.3 Efektiviteti i trenave

Janar – Mars 2024	Pesha max. bartëse t/tren	Mesatarja e çdo treni - bt	Efektiviteti (%)
Import	1200	0.00	0.00 %
Eksport	1200	0.00	0.00 %
Vendor	1400	0.00	0.00 %

Tabela 5.6

V.4 Neto-ton & neto-ton kilometër të transportuar

Neto ton	Realizim Janar-Mars 2025	Planifikim Janar-Mars 2025	Realizim/Planifikim 2025 në %	Neto ton kilometër	Humbje Planifikim/Realizim 2025 (ton)
Import	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Export	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Vendor	0	105,000	0.00 %	0.00	-105,000
Total	0	105,000	0.00 %	0.00	-105,000

Tabela 5.7

V.5 Revokimi i trenave

Gjatë periudhës janar – mars 2025 ka pasur revokime të trenave të planifikuar, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import-export) dhe transport vendor:

Janar Mars 2025	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	78	0	0	0	0.00 €
Vendor	0.00	228	0	0	999.78 €
Total	78	228	0	0	999.78 €

Tabela 5.8

Në tabelën më lart shihet se gjatë periudhës janar – mars 2025 në import dhe eksport janë revokuar në total 78 trena me 0%, të planifikuar sipas OLT-së.

Ndërsa në transportin vendor gjatë periudhës janar – mars 2025 në total janë 228 trena të revokuar me 10%, vlera e revokimeve është 999.78 €.

Revokimet e këtyre trenave në transport vendor kanë ardhur si pasojë e mos fillimit të transportit të planifikuar nga NewCo Ferronikeli.

V.6 Organizimi i tërheqjes me lokomotiva dhe manovruese – shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara

Shpenzimet e lokomotivave tërheqëse dhe manovruese -Transporti i mallrave Janar-Mars 2024							
Muaji	Shp/km	2640-007	2640-008	2710-009	2640-010	2760-001	Totali
Janar	Shp.Naftë	0.00	0.00	0.00	0,00	360	360
	Kilometrat	0.00	0.00	0.00	0,00	30	30
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0,00	12	12
Shkurt	Shp.Naftë	0.00	0.00	0.00	0,00	150	150
	Kilometrat	0.00	0.00	0.00	0,00	30	30
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0,00	5	5
Mars	Shp.Naftë	0.00	0.00	0.00	0,00	0,00	0,00
	Kilometrat	456	9	0.00	0,00	44	509
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0,00	0,00	0,00
Janar - Mars 2024	Shp.Naftë	0.00	0.00	0.00	0,00	510	510
	Kilometrat	456	9	0.00	0,00	104	569
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0,00	4.90	0.90

Tabela 5.9

VI. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE -MML

VI.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës 01 Janar – 31 Mars 2025, duke krahasuar me realizimin e tre mujorin të parë (TM1) të vitit 2024.

VI.2 Sektori i mirëmbajtjes

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: Mirëmbajtja e trenave motorik, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

VI.2.1 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara në periudhën Janar- Mars 2025 krahasuar me periudhën Janar – Mars 2024

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar- Mars 2025	Janar- Mars 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.1

VI.2.2 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në periudhën Janar – Mars 2025 krahasuar me periudhën Janar – Mars 2024

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar-Mars 2025	Janar-Mars 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	85	84	+1
2.	Riparime	14	14	0
3.	Kontrollime K1	9	4	+5
4.	Kontrollime K3	2	1	+1
5.	Kontrollime K6	1	0	+1
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 6.2

VI.2.3 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën Janar- Mars 2025 krahasuar me periudhën Janar- Mars 2024

	Lloji i Riparimit/Mirëmbajtjes	Janar-Mars 2025	Janar – Mars 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	4	1	+3
3.	Kontrollime K1	3	0	+3
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.3

VI.2.4 Intervenimet në mjetet tërheqëse

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës tre mujore (Janar – Mars 2025) për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjetet tërheqëse (Nr.)	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime (S)	13	0	0	0	0	72	0	0	0
Riparime (R)	3	3	0	0	0	8	4	0	0
Kontrollime (K 1)	2	3	2	0	0	2	3	0	0
Kontrollime (K 3)	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Kontrollime (K 6)	0	0	0	0	0	1	0	0	0
Gdhendje të rrotave	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 6.4

Servisime – S

Riparime – R

Kontrollime njëmuajor – K1

Kontrollime tremujor – K3

Kontrollime gjashtëmuajor – K6

VI.2.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtareve realizuar në periudhën Janar-Mars 2025, krahasuar me periudhën Janar – Mars 2024.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar- Mars 2025	Janar – Mars 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime (K1)	11	16	-5
2.	Riparim në punëtori	20	23	-3
3.	Gdhendje të rrotave	0	7	-7
4.	Testim i komponentëve	0	0	0
5	Riparime në stacion	0	2	-2

Tabela 6.5

IV.2.6 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuar në periudhën Janar – Mars 2025, krahasuar me periudhën Janar – Mars 2024

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar – Mars 2025	Janar – Mars 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	0	0
2.	Riparim në punëtori	0	0	0
3.	Riparim në teren	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

Tabela 6.6

VI.2.7 Riparimi i vagonëve të huaj

Gjatë këtij tre mujori, Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse nuk ka pasur kërkesa për riparim të vagonëve të huaj.

Në tabelën nr.6.7, janë paraqitur vlerat e punëve të kryera për periodën Janar – Mars 2025 dhe është krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	Janar – Mars 2025	Janar – Mars 2024
NewCo Ferronikeli	00.00 €	00.00 €

Tabela 6.7

VII. PROJEKTET DHE PROKURIMI

Në tabelën 7.1 janë paraqitur projektet të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës janar – mars 2025:

Nr	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Data e nënshkrimit	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Shërbimet e abonimit të arkave fiskale	Shkurt 2024	4,319.98	4,319.98	Në implementim
2	Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit financiar PLANET Accounting	Janar 2024	10,800.00	10,800.00	Ne implementim
3	Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	Dhjetor 2023	9,500.00	7,839.97	Në implementim
4	Furnizimi me modul kontrolle për diesel motor të tipit 8-710G3B-2		8,000.00		Anuluar
5	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)	Mars	16,000.00	15,147.36	Në implementim
6	Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë të udhëtareve)	Shkurt	14,000.00	13,196.47	Përfunduar
7	Furnizimi me modul për lokomotivën G1700		6,500.00		Anuluar
8	Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645	Shkurt	7,500.00	4,472.20	Përfunduar
9	Furnizimi me laptop për nevojat e Bordit të Drejtoreve të Trainkos Sha	Janar	2,400.00	1,090.00	Përfunduar
10	Furnizimi me material Higjienik	Mars	50000	1,482.73	Ne Zbatim
11	Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve		229,610.00		Njoftimi për kontratë
12	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016		100,000.00		Njoftimi për kontratë
13	Furnizimi me injektor për motor 645 E3 të lokomotivave GT22HW-2	Shkurt	7,000.00	6,159.60	Përfunduar

1. **Shërbimet e abonimit të arkave fiskale** – Projekti është kontraktuar dhe është në zbatim.
2. **Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit financiar PLANET Accounting** – Është nënshkruar kontrata më datën 10.01.2024. Projekti ka kohëzgjatje trevjeçare dhe është procedurë e negociuar pa publikim.
3. **Shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare për vitet 2023, 2024, 2025** – Projekti është kontraktuar për periudhë trevjeçare dhe është në zbatim. Operatori Ekonomik ka përfunduar pjesën e dytë të kontratës për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2024 dhe e njëjta është faturuar.
4. **Furnizimi me modul kontrolle për motorët diesel të tipit 8-710G3B-2** – Është anuluar për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.
5. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (furnizimi me filtra për lokomotiva)** – Është dërguar edhe kësti i fundit për pagesë dhe janë bërë ndalesat administrative për vonesat nga Operatori Ekonomik.
6. **Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezervë për MML II (furnizimi me xhama për vagonë të udhëtarëve)** – Projekti ka përfunduar dhe është pranuar. Fatura është dërguar për pagesë.
7. **Furnizimi me modul për lokomotivën G1700** – Projekti është anuluar për shkak të tejkalimit të buxhetit. I njëjti është shpallur përsëri.
8. **Furnizimi me modul TH14 për lokomotivën GM 645** – Është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
9. **Furnizimi me laptop për nevojat e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A.** – Është pranuar nga komisioni teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.
10. **Furnizimi me material higjienik** – Është shpallur oferta fituese dhe është nënshkruar kontratë me O.E. PM GROUP SH.P.K., me vlerë 1,482.73 €.
11. **Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve** – Hapja e tenderit do të bëhet më datën 02.05.2025.
12. **Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016** – Njoftimi për kontratë është bërë më datën 12.03.2025, ndërsa hapja e ofertave do të bëhet më datën 04.04.2025.
13. **Furnizimi me injektor për motorin 645 E3 të lokomotivave GT22HW-2** – Projekti është pranuar nga komisioni i pranimit teknik dhe fatura është dërguar për pagesë.

VIII. KONTESTET LIGJORE

Gjatë periudhës kohore janar – mars 2025, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2025, pranë Gjykatave Themelore dhe Komerciale kanë qenë të caktuara 10 seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të paditurës apo të paditëses.

Gjatë tre mujorit të parë të këtij viti ndërmarrja në procedurë gjyqësore është përballur dhe ka zhvilluar veprime procedurale në 9 konteste për kompensim dëmi, 2 konteste pune, 1 konteste në procedurë përmbarimore, 1 lëndë pagim borxhi dhe 1 lëndë me procedurë penale 1 lëndë me aktgjykim të Gjykatës Supreme në Prishtinë refuzohet kërkesëpadia e paditësit ,1 lëndë me Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë konstatohet tërheqja e padisë së paditësve, 1 lëndë me Aktgjykim nga Gjykata Komerciale në Prishtinë, ku aprovohet pjesërisht kërkesëpadia në favor të Kompanisë Trainkos Sh.A, 1 lëndë me Aktgjykim nga Gjykata e Apelit në Prishtinë , refuzohet ankesa e paditësit,1 lëndë me Aktvendim për përgjigje në padi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, 1 lëndë me aktvendim nga Gjykata Themelore në Prishtinë pezullohet procedura e kreditorit, si dhe 1 Ekspertizë Komunikacioni.

Gjatë kësaj periudhe kemi parashtruar 1 ankesë në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, 1 përgjigje në padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

VII.1 Kontestet gjyqësore për vitin 2025

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. në vitin 2025, pritet të ballafaqohen me **63** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale të përshkruar sipas aktivitetit në tabelën e mësipërme:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	////////
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	9
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	27
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	5
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbarimore	20
6.	Lëndë në procedurë penale	1
7.	Totali	63

Tabela 8.1

IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

IX.1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Përkundër vazhdimësisë në realizimin e të hyrave nga Marrëveshja e OShP-së (2023 – 2027) për vitin 2025, transporti i planifikuar nga shërbimet për mallra nuk ka ndodhur. Edhe për këtë periudhë ashtu si në pjesën e fundvitit 2024 janë vonesat e përfundimit të punëve që janë duke u zhvilluar në modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore. Nëse e kemi parasysh se Linja e 10-të hekurudhore është arteria bazë e rrjetit hekurudhorë në dhe nga Kosova atëherë kjo është pengesë esenciale në zhvillimin e biznesit të kompanisë për transport me hekurudhë dhe realizimin e projekteve tjera po ashtu shumë esenciale për të ardhmen. Pritjet tona që Linja të lëshohet në shfrytëzim sipas orareve të paralajmëruara nuk kanë ndodhur, nga kjo vazhdon mosplotësimi i planifikimeve tona për transportin e mallrave dhe udhëtarëve sipas planifikimeve dhe kërkesave që dalin për sektorin hekurudhor nga planifikimet dhe strategjitë e shtetit të Kosovës.

IX.2 Aktivitetet në transportin e mallrave përgjatë periudhës Janar – Mars 2025

Nga klientët vendorë, me të cilët kemi pasur të nënshkruar aneks kontratë për transport deri më 31.12.2023 ka qenë vetëm një, klienti nuk ka vazhduar kontratën gjatë vitit 2025:

Nr.	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NewCo Ferronikeli	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

*Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2025 janë gjithsej tre (3) partnerë. Duhet theksuar se këta partnerë që kanë nënshkruar kontratë transporti janë ndërkombëtarë, të njëjtit kanë pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2023, përjashtimisht klienti/partneri **Schenker DB dhe Fershped AD**.*

Lista e partnerëve ndërkombëtarë:

Nr	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NAVICO SHIPPING DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2	CARGO LOGISTC DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3	ARGO LOGISTIC INT	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

IX.3 Aktivitetet në fushën promovuese gjatë periudhës Janar – Mars 2025

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura Sektori i Marketingut kryen edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut. Sektori i Marketingut ka qenë gjithmonë në përcjellje të organizimeve grupore të cilat janë aprovuar dhe janë realizuar me vagonë të udhëtarëve, nëpërmjet kërkesave të veçanta për

shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A. Po ashtu, gjatë tërë kohës mbajmë kontakte me udhëtar aktual dhe potencial të cilët bëjnë pyetje nëpër rrjetet sociale.

Kërkesat që kemi pasur për shfrytëzim të aseteve, shërbimeve të veçanta gjatë periudhës Janar – Mars 2025 janë si në vijim:

Nr.	Data e shfrytëzimit	Institucioni	Lloji i Shfrytëzimit
1	24.02.2025	Montesori - Pejë	Transporti i nxënësve
2	25.02.2025	Montesori - Pejë	Transporti i nxënësve
3	06.03.2025	Televizioni ATV	Xhirime për emision
4	17.03.2025	Ballkan Expres – latitudes	Organizim grupor

IX.4 Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera

Edhe në fillimin e vitit 2025 vazhdon të mbetet pengesë gjendja aktuale e linjave hekurudhore brenda vendit dhe lidhja me hekurudhat e shteteve në regjion për zhvillimin e biznesit. Gjendja dhe vonesat në përfundimin e projekteve për modernizimin e Linjave hekurudhore po pamundëson shfrytëzimin e potencialit nga Portet Detare dhe Linjave tjera hekurudhore që mundësojnë transportin me hekurudhë me pjesën tjetër të Evropës dhe Botës. Gjatë periudhës raportuese bashkëpunimi me Hekurudhat Maqedone ka qenë në lehtësimin e procedurave për bartjen dhe transportin e Lokomotivës Ambasadore Di3.619 për Augsburg (Gjermani), janë marrë veprimet e kërkuara që kanë të bëjnë me procedura të parapëlqyera. Sipas kërkesës dhe faktit se TRAINKOS-i është pronar i lokomotivës është proceduar me kërkesë formale për të e përcjellë lokomotivën nga Hani i Elezit deri në punëtori Shkup për të bërë kontrollin teknik të nevojshëm që plotëson standardet për Certifikatë sipas UIC-it. Sipas kërkesës gjatë periudhës raportuese është caktuar një takim i përbashkët mes stafit teknik për mirëmbajtje me Hekurudhat Maqedone – Transporti, kjo do të ndihmojë përfundimin sa më të shpejtë të procesit të konfirmimit të gjendjes së Lokomotivës për transport sipas standardeve të UIC-it. Pritet që ky proces të përfundojë së shpejti dhe Lokomotiva të dërgohet në destinacionin e aprovuar sipas Marrëveshjes.

Veprimet konkrete për realizimin e idesë për ndërtimin e linjës hekurudhore që lidhin Shqipërinë dhe Kosovën ka rezultuar me hapa të rëndësishëm dhe shpresëdhënës për të ardhmen e transportit me hekurudhë në regjion. Studimi i fizibilitetit për Linjën hekurudhore që lidh shtetet tona kanë përfunduar dhe janë prezantuar në forma pompoze nga takimet e mbajtura të faktorëve vendimmarrëse të shtetit të Shqipërisë dhe Kosovës. Nga studimet e prezantuara është kuptuar që Linja do të ketë qendrën kyçe (në Shqipëri) Shkodrën dhe pastaj do të vazhdojë deri në Gjakovë për të u lidhur tutje me Linjat ekzistuese brenda territorit të Kosovës. Përkundër planifikimeve që mund të marrin një dekadë në tërë këtë proces TRAINKOS-i duke i përcjellë këto zhvillime duhet të ndërtojë kapacitete e domosdoshme teknike dhe njerëzore dhe të fillojë bashkëpunimin për punët e përbashkëta në operim me trena që na presin në zhvillimin e radhës. Kjo sidomos në realizimin e mundësisë për shfrytëzimin e porteve detare nga Adriatiku (Vlora, Durrësi, Shëngjini dhe

Tivari) dhe realizimin e idesë tanimë të shndërruar në projekt të “Portit të Thatë” në Fushë Kosovë i cili është edhe në PSP të transportit dhe PIP të Qeverisë.

IX.5 Pjesëmarrja e Trainkos-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Përkundër kufizimeve të pjesëmarrjes në aktivitetet që ndërmerr Bashkësia Evropiane përmes DG MOVE në iniciativat për Lëvizshmëri të Qëndrueshme gjatë fillimit të vitit 2025 janë përcjellë prezantime (në Web faqe dhe përmes E-melit) që kanë të bëjnë me hapat që TRAINKOS-i ka interes. Veprimet e mëposhtme kanë ndodhur gjatë tremujorit të parë të vitit 2025:

1.Kanë ndodhë procese në finalizimin e Ligjit të Ri për Hekurudha dhe Ligjit për Siguri dhe Ndërveprueshmëri, konkretisht janë punuar Draftet nga Grupi punues i caktuar për këtë qëllim dhe pritet së shpejti të përcillet në procedurat e mëtutjeshme. Më këtë do të plotësohen kriteret e funksionimit modern të transportit hekurudhorë dhe kompletimi i dokumentacionit bazë që trason vazhdimin e reformave në legjislacionin që rregullon transportin modern me hekurudhë dhe

2.Nga Sekretariati për Zbatimin e Traktatit për Transport është jetësuar mundësia e krijimit të “Qendrës rajonale” për trajnimin e personelit për transportin me hekurudhë. Nga kjo iniciativë me pëlqimin e DG MOVE është angazhuar stafi profesional i Hekurudhave Gjermane. Pritet rezultati nga studimi dhe analiza e ekipit të caktuar për këtë qëllim dhe hapat e radhës që mund të ndodhin.

IX.6 Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante për proceset që ndërlidhen me këto entitete

Vazhdojnë të mbesin angazhimet në plotësimin e obligimeve ligjore në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), Ministrinë e Ekonomisë (ME), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Ndër aktivitetet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese vlen të veçohen:

- Është bërë analiza e domosdoshme në trasimin e procedurave dhe obligimeve që TRAINKOS duhet të i përcjellë për futjen në funksion të pesë vagonëve të udhëtarëve pas finalizimit të procesit riparimi i mesëm. Pasi që të njëjtit aktualisht janë në Han të Elezit, obligim i radhës i TRAINKOS-it është që zyrtarisht të njoftoj ARH-në kohë e futjes në qarkullim. Natyrisht kjo kur të dihet pasi që situata e krijuar me mbylljen e Linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit e pamundëson këtë;
- Proces i inspektimit të mjeteve lëvizëse në posedim të TRAINKOS-it nga ARH është finalizuar dhe përcjellë zyrtarisht tek TRAINKOS-i më 10.01.2025. Raporti prezanton gjendjen reale të të gjitha mjeteve lëvizëse (tërheqëse dhe të tërhequra), njëkohësisht

prezanton rekomandimet që TRAINKOS-i duhet të ketë kujdes për të i plotësuar gjatë vitit 2025;

- Me kërkesën e zyrtarëve të ESK-së është filluar me plotësimin e tabelave të Anketës për Statistikat e Investimeve që i përkasin Ndërmarrjes sonë;
- Për nevojat e Ndërmarrjes INFRAKOS sipas kërkesës që rrjedh nga obligimet ligjore është përgatitur, plotësuar dhe dërguar pyetësi për kënaqësi të klientëve. Në këtë rast si klientë për shërbimet si operatorë dhe shfrytëzues i Terminalit;
- Është punuar, kontrolluar dhe dërguar tek ESK formati i plotësuar në tabelë që përmbajnë Anketën për Statistikat e Investimeve të ndodhura në vitin 2023;
- Sipas kërkesës dhe nevojës për të i konfirmuar statistikën për transport me hekurudhë që do të përfshihen në të dhënat që dërgohen në EUROSTAT janë punuar, konfirmuar dhe dërguar tek përgjegjësit në ESK;
- Angazhim përmes përfaqësimit dhe konsultave të brendshme për hartimin e Ligjit të Ri për hekurudhat dhe Ligjit për Siguri dhe Ndërveprueshmëri;
- Finalizimi i procedurave nga ana e TRAINKOS-it për transportimin e Lokomotivës Ambasadore në Augsburg;
- Është organizuar dhe realizuar vizita e rregullt vjetore e përgjegjësve të ARH-së për gjendjen dhe kënaqshmërinë e udhëtarëve gjatë udhëtimit me tren;
- Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet e rregullta mujore për statistikën e transportit të realizuar nga TRAINKOS-i në ARH;
- Është punuar me ARH-në dhe ka përfunduar procedurat e rregullta në shqyrtimin e kërkesës sonë për Ri licencimin e 6 makinistëve dhe konfirmimin e mos licencimit të makinistëve që nuk llogarisim në vazhdimin e punës si makinist në Ndërmarrje. Kjo në bazë të listës së makinistëve më 19.03.2015 që ju ka skaduar licenca e vlefshme për 10 vjet;
- Për nevojat e raportimeve dhe evidencave nga ARH është kërkuar konfirmimi i transportit të realizuar nga TRAINKOS për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Të njëjtat janë analizuar, ri konfirmuar dhe dërguar me kohë sipas kërkesës;
- Janë kompletuar të dhënat (statistikat në baza mujore) sipas kërkesës së ASK dhe obligimeve ligjore për statistika në baza mujore.

X.SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS 2025 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

HK-Trainkos Sh.A. edhe nga fillimi i vitit 2025 është ballafaquar me vështirësi dhe sfida, të cilat e kanë përcjellë edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, janar-mars 2024. Prej këtyre sfidave, ndër më kryesoret, kemi veçuar ato si në vijim:

1. Ballafaqimi në vazhdimësi me ndërprerje të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit për qarkullim gjatë Modernizimit të këtij sesi për shkak të vonesave në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore”;
2. Mjete lëvizëse hekurudhore tërheqëse (lokomotivat) dhe të tërhequra (vagonët) të pakta në numër dhe jo në gjendje të mirë për shkak të vjetërsisë së tyre, Transporti i udhëtarëve zhvillohet me trena klasikë, në vend të trenave të lehtë (Garnitura Motorike) të cilët janë shumë më ekonomikë;
3. Shuma e ndare për investime kapitale është e pa mjaftueshëm për zhvillimin e ndërmarrjes për ripërtëritje të mjeteve lëvizëse për plotësimin e nevojave në transport të udhëtarëve dhe atë të mallrave ;
4. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
5. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
6. Mos funksionimi i të gjitha linjave tjera hekurudhore brenda vendit;
7. Mos zbatimi i bazës ligjore dhe mungesa e legjislacionit sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
8. Në njërin anë mungesë e kuadrove profesionale si inxhinierë të komunikacionit dhe transportit dhe makinerisë, dhe staf teknik profesional (*ekziston rreziku, që edhe i stafit ekzistues të largohen shkak i pagave të ulëta, krahasuar me rajonin*), ndërsa në anën tjetër numër i madh i të punësuarve administrativë;
9. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv, nevoja për staf të ri dhe të kualifikuar që mund të përcjell trendin e zhvillimit të reformave/zhvillimeve në sektor.

Për të gjitha problemet dhe vështirësitë e theksuara në këtë raport, pavarësisht angazhimit e përkushtimit të Ndërmarrjes, do të jetë e vështirë që këto të tejkalohen pa mbështetje edhe nga institucionet dhe faktorët tjerë relevantë. Në gjendjen ekzistuese është e domosdoshme kjo mbështetje që HK-Trainkos Sh.A. të vendoset në rrugën e zhvillimit dhe të arrijë atë nivel të funksionimit në sate të veprimtarisë së vet.

Fushë Kosovë,
Prill 2025

Agron Statovci
Kryeshef Ekzekutiv

